



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1034/2 prot.,

Datë 23.04.2025

V E N D I M

Nr. 539/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergji Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.04.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: 1. Urdhër për pezullim procedure prokurimi

Subjekte të interesuar: Bashkia Durrës
Sheshi “Liria”, Durrës

BOE “LIS KONSTRUKSION” SHPK me NIPT K66613407H dhe adresë Bulqize Diber Bulqize, Lagjja Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15 & “MURATI” SHPK me NIPT J66702413V.

Agjencia e Prokurimit Publik
Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i Ministrave, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligji nr. 97/2019 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nenit 42 e vijues”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit

të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi informacionin e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues,

Vëren:

1. BOE “LIS KONSTRUKSION” SHPK & “MURATI” SHPK kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)”, me Nr. REF-43772-04-04-2025, me objekt: “Riaftësim strukturor i pallatit nr.167 ”Viko” lagja 13 , Plazh, Rruga Pavarsia”, me fond limit 168,410,054 (njëqind e gjashtëdhjet e tetë milion e katërqind e dhjetë mijë e pesëdhjet e katër) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 17.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës, në procedurën e mësipërme të prokurimit.
2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës si dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj, në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; nenit 42, pika 10 të Ligjit nr. 97/2019 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” ; nenit 61 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të urdhërojë pezullimin e procedurës së prokurimit “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)”, me Nr. REF-43772-04-04-2025, me objekt: “Riaftësim strukturor i pallatit nr.167 ”Viko” lagja 13 , Plazh, Rruga Pavarsia”, me fond limit 168,410,054 (njëqind e gjashtëdhjet e tetë milion e katërqind e dhjetë mijë e pesëdhjet e katër) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 17.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës, në procedurën e mësipërme të prokurimit dhe moskryerjen e asnjë veprimi nga autoriteti kontraktor deri në shqyrtimin e ankesës dhe marrjen e vendimit përfundimtar.
2. Autoriteti Kontraktor të dërgojë menjëherë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave; të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, si dhe të gjithë materialet e paraqitura nga shoqëritë pjesëmarrëse.

3. I gjithë informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar, të paraqitet jo më vonë se dita e nesërme e punës nga data e marrjes së këtij vendimi, dhe të jetë shoqëruar me një Proces-Verbal në të cilin të pasqyrohet emërtimi i dokumentave me numrin e fletëve përkatëse.
4. Për efekt shpejtësie në procesin e shqyrtimit administrativ, komunikimi dhe dërgimi i dokumentacionit të kërkuar më sipër, do të bëhet në mënyrë elektronike në adresën Kpp_info@kpp.gov.al.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

